



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosova  
Qeveria e Kosovës – Vlada Kosova – Government of Kosova



MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS  
DHE TEKNOLOGJISË


MINISTRY OF EDUCATION  
SCIENCE AND TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE  
NAUKE I TEHNOLOGIJU

QENDRA E STUDENTËVE  
E UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS  
PRISHTINË

STUDENTS' CENTER OF  
UNIVERSITY OF PRISHTINA  
PRISHTINA

STUDENTSKI CENTAR  
UNIVERSITETA PRISHTINE  
PRISHTINA



Pruga "Agim Ramadani" p.n., 10 000 Prishtinë, Kosovë  
Tel.: +381 (0) 38/223-951, +381 (0) 38/225-976  
web: [www.qendraestudenteve.com](http://www.qendraestudenteve.com)

Në bazë të nenit 15 pika 2.3 dhe 2.6 të Statutit të Qendrës së Studentëve të Universitetit të Prishtinës dhe në mbështetje të rregullores Nr.13/2014 dhe nenit 5 al.1 për Qendren E Studenteve te Universitetit të Prishtinës, Drejtori i Përgjithshëm, aprovoi këtë:

## **R R E G U L L O R E** **MBI RENDIN SHTËPIAK TË QENDRËS SË STUDENTËVE NË** **PRISHTINË**

### **Neni 1**

#### *Qellimi*

Me këtë Rregullore përcaktohet rendi shtëpiak në Qendrën e Studentëve në Prishtinë.

### **Neni 2.**

Dyert e hyrjes në konvikt janë të hapura nga ora 05:00 deri në 22:00 në sezonin e llogaritjes dimërore të kohës dhe nga ora 05:00 deri në 23:00 në sezonin e llogaritjes verore të kohës. Orari mund të ndryshohet me vendim të posaçëm të Drejtorit të Përgjithshëm të Qendrës së Studentëve.

### **Neni 3**

Hyrja në konvikt është e lejuar edhe pas kësaj kohe në rastet kur organizohen:

- Mbrëmje të absolventëve,
- Mbrëmje të brucoshëve,
- Mbrëmje shoqërore,
- Aktivitete arsimore, kulturore e artistike (ligjërata publike, koncerte, shfaqje teatrale, t.j.) Për rastet e mësipërme është e nevojshme që paraprakisht të sigurohet pëlqimi i udhëheqësit të konviktit. Me këtë rast, organizatori i cili e kërkon lejen, personi zyrtar duhet t'i dorëzojë regjistrin e studentëve banues në konvikt, bashkë me numrin e dhomës dhe numrin e lejes për hyrje në konvikt. Një kopje e regjistrin bashkë me leje duhet të dorëzohet në recepcion.



#### Neni 4

Lejohen vizitat e palëve të të njëjtës gjini, nga konviktet e Qendrës së Studentëve gjatë kohës prej orës 10:00 e deri në orën 17:00 për çdo ditë të javës.

Vizitat e studentëve banuesve lejohen në konviktet gjinisë mashkullore nga ora 10:00 deri në 17:00. Studenteve femra u lejohet të hyjnë pasi të jetë evidentuar në fletoren e vizitave dhe ndaljes së dokumentit. Vajzat kanë të drejtë të vizitohen në dhomë vetëm nga prindërit.

Lejohen vizitat e anëtarëve të familjes së ngushtë çdo ditë të javës prej orës 08:00 deri në orën 17:00.

Palët duhet të posedojnë me vete dokumentin zyrtar që dëshmon afërsinë familjare ndërmjet personit që vizitohet dhe vizitorit dhe evidentohet në fletore të vizitave.

#### Neni 5

Punëtori në recepcion është i obliguar të respektojë me përpikëri kërkesën e studentit, në rast se nuk bie ndesh me nenet e kësaj rregullore.

#### Neni 6

Furnizimi me ujë në lokalet e përbashkëta është i përditshëm. Reduktimi i orarit të furnizimit me ujë nga ana e punonjësve të Qendrës nuk guxon të bëhet. Kufizimet e pjesshme mund të bëhen vetëm në rastet urgjente, me qëllim të parandalimit të dëmeve materiale.

Qendra nuk është përgjegjëse për kufizimet që sipas planit i ndërmerr Drejtoria e sistemit të ujësjellësit "Batllava" në Prishtinë.

#### Neni 7

Orari i furnizimit të shfrytëzuesve me ujë të ngrohtë duhet të përpilohet në fillim të sezonit dhe mund të ndërrohet brenda një sezoni. Reduktimi i orarit të furnizimit me ujë të ngrohtë nuk guxon të bëhet. Kufizimet e pjesshme mund të bëhen vetëm në raste urgjente, me qëllim të parandalimit të dëmeve materiale.

#### Neni 8

Furnizimi me ngrohje bëhet sipas orarit të shfrytëzimit që përcakton OP "Termokos", në Prishtinë. Në rast të ngrohjes jo cilësore qendra siguron ngrohje cilësore me shtimin e temperaturës së ujit të nxehtë nga kaldajat e saj. Temperatura në dhomat e studentëve gjatë sezonit të ngrohjes nuk guxon të jetë nën optimumin që parashihet me ligjin përkatës.

#### Neni 9

Studentët shfrytëzues të resurseve të qendrës në rast të alarmit për rrezik nga zjarri apo rrezik nga fatkeqësitë tjera elementare (tërmeti, shembje e objektit etj.), do të udhëzohen menjëherë nga personat e autorizuar për veprimet që ata duhet t'i ndërmarrin.

#### Neni 10

##### Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja mbi rendin shtepiak të Qendrës së studentëve në Prishtinë nr.45 të dt. 06.02.2008

#### Neni 11

##### Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Qendrës së Studentëve.

Prishtinë, 29.03 2017

Drejtori i përgjithshëm:  
Fatmir Sifita

